

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXII, nr. 6750
E shtunë, 5 nëntor 2022
çmimi 0.40

Scholz: Me Francën po i shtyjme Kosovën dhe Serbinë drejt marrëveshjes | FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

MBROJTJA E THAÇIT ZBULON IDENTITETIN E TETË DËSHMITARËVE NDËRKOMBËTARË



Në mesin e dëshmitarëve që mbrojtja e Hashim Thaçit dëshiron të thërrasë për dëshmi janë ish-diplomatë dhe ish-zyrtarë të lartë të NATO-s. Në listën e paraqitur të dëshmitarëve përfshihen: Wesley Clark, William Walker, Bernard Kouchner, Daan, W. Everts, Michael Durkee, Jock Covey dhe Steve Bennett

RASTI THAÇI DHE TË TJERËT, GJYKATËSI: ÇËSHTJA DO TË KALOJË TE TRUPI GJYKUES PARA FUNDIT TË VITIT | FAQE 3



LIBERALIZIMI I VIZAVE PËR KOSOVËN DUHET TË TRAJTOHET URGJENTISHT | FAQE 7

OPINION

RESPEKTIMI I SOVRANITETIT DHE INTEGRITETIT TERRITORIAL TË UKRAINËS | F. 6

Ambasadori Jeffrey M. HOVENIER



AKTUALE



ZELENSKY AKUZON RUSINË PËR "TERRORIZËM ENERGETIK" | F. 2

SAMITI I ARDHSHËM MIDIS BE-së DHE BALLKANIT PËRËNDIMOR, MË 6 DHJETOR NË TIRANË | F. 5

EKONOMI



RIZVANOLLI DISKUTON ME SEKTORIN PRIVAT PËR FURNIZIMIN ME ENERGI | F. 8

TË HYRAT TATIMORE ARRINJË SHIFRËN 623.6 MILIONË EURO | F. 8

SPORT



SONTE PËRBALEN RAHOVECI - VËLLAZNIMI, NESËR DY NDESHJE TË TJERA | F. 10

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
+389 44 487 200
+389 44 487 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Zelensky akuzon Rusinë për ‘terrorizëm energjetik’

KIEV, 4 NËNTOR - Rusia lëshoi dronë të tjerë kamikazë në infrastrukturën dhe objektet civile në Ukrainën juglindore, kanë njoftuar zyrtarët ukrainas më 4 nëntor.

Pas dëmtimit të madh në rrjetin elektrik, që erdhi si pasojë e këtij sulmi, miliona ukrainas kanë mbetur pa energji elektrike. Kjo e ka shtyrë presidentin Volodymyr Zelensky që ta akuzojë Moskën për “terrorizëm energjetik”.

Valentyn Reznichenko, guvernator i rajonit Dnipropetrovskov, ka thënë se ushtria ukrainase ka shkatërruar tetë dronë Shahed-136 në rajonin jugor të Nikopolit. Ai ka thënë se trupat ruse kanë goditur, gjithashtu, katër vendbanime në të njëjtin distrikt me raketa Grad dhe zjarr artilerie dhe kanë dëmtuar një tubacion gazi dhe një linjë energjie, si dhe kanë shkatërruar disa ndërtesa banimi.

Zelensky ka thënë në fjalimin e tij më 3 nëntor, se më shumë se 10 për qind e popullsisë së paraluftës në Ukrainë, ose 4.5 milionë banorë, kanë mbetur përkohësisht pa energji elektrike për shkak të sulmeve ruse. “Vetë fakti që Rusia po përdor terrorizmin energjetik tregon dobësinë e armikut tonë. Ata nuk mund ta mundin Ukrainën në fushëbetje, kështu që ata përpiqen ta thyjnë popullin tonë në këtë mënyrë”, ka theksuar ai.

Ka disa javë që Rusia është duke shënjestruar infrastrukturën ukrainase të energjisë dhe ndërtesa civile, me raketa, dronë dhe sulme artilerie, teksa ushtria ukrainase zgjeron kundërofensivën në lindje dhe juglindje.

Rusia deri më tani ka shkatërruar më shumë se 40 për qind të infrastrukturës ukrainase të energjisë.



Ndërrhyrje të huaja për t'i përçarë votuesit amerikanë në prag të zgjedhjeve për në Kongres

UASHINGTON, 4 NËNTOR - Llogari të rreme në rrjetet sociale nga përdorues të huaj e vendas kanë për qëllim të provokojnë dhe përçajnë votuesit amerikanë, duke vënë në dyshim integritetin e sistemit të votimit në Shtetet e Bashkuara. Kjo është një ndër sfidat e shumta në zgjedhjet e këtij viti për Kongresin Amerikan që mbahen javën që vjen, më 8 nëntor. Korrespondentja e “Zërit të Amerikës”, Michelle Quinn, sjell më shumë hollësi nga qyteti Finiks i Arizonës.

Llogaritë e rreme në rrjetet sociale, që besohet se janë krijuar në Rusi, nuk ishin aktive në pjesën më të madhe të vitit, ka treguar eksperti i zbulimit, Brian Liston. Kjo ndryshoi në gusht derisa po afroreshin zgjedhjet për Kongres. “Pamë që këto llogari filluan të aktivizohen duke postuar për mashtrime zgjedhore, ose se zgjedhjet ishin të vjedhura dhe se demokratët do të përpiqen t'i manipulojnë zgjedhjet”, ka thënë Liston.

Ai është pjesë e një rrjeti të përbërë nga studiues, ekspertë të sigurisë kibernetike, agjenci qeveritare dhe të tjerë, që përcjellin rrjetet sociale, faqet e internetit, mediet shtetërore dhe njoftimet e organeve ligj-zbatuese për t'i gjurmuar fushatat e koordinuara të keqinformimit nga kundërshtarët e Shteteve të Bashkuara si Rusia, Kina dhe Irani.

Faqet e lajmeve të rreme nga organizata të lidhura me qeveritë e këtyre vendeve përhapin njoftime përçarëse për Amerikën,



të cilat më pas shpërndahen nga persona të rremë në rrjetet sociale, që pretendojnë se janë amerikanë.

Qëllimi i Ruisë është përçarja dhe bindja e amerikanëve se sistemi i votimit nuk është i besueshëm, thotë zoti Liston. Sipas tij, operatorët kinezë vënë në dukje postimet e shumta mbi integritetin e zgjedhjeve, si dëshmi se demokracia amerikane është jofunksionale. “Edhe pse

flasin për manipulime dhe vjedhje votash, unë jam i shqetësuar se ndoshta këto llogari aktivizohen në ditën e zgjedhjeve për të nxitur dhunë ose frikësim të punonjësve elektoralë në qendra të votimit”, thotë Liston.

Në shtetin jugperëndimor të Arizonës, votuesi Dylan Murphy shprehet i shqetësuar për pasojat që keqinformimi në internet mund të ketë në botën reale. “Shqetësimi im është se persona

të huaj mund të përhapin dezinformata dhe teori konspirative përmes rrjeteve sociale, duke përçarë amerikanët në atë shkallë, sa të tejkalojnë rrjetet sociale. Pasoja të këtyre teorive konspirative janë bërë më të dukshme kohët e fundit. Kemi njerëz që vijnë të armatosur në qendrat e votimit në Arizonë”, thotë ai.

Arizona është mes shteteve që ngrii dyshime mbi rezultatet e

zgjedhjeve presidenciale para dy vitesh. Rinumërimi i kërkuar nga republikanët në qarkun Maricopa, konfirmoi përfundimisht fitoren e Joe Biden-it.

Shumë mbështetës të Donald Trump-it vazhdojnë të thonë se zgjedhjet u vodhën, mes tyre edhe kandidatja republikane e Arizonës për guvernatore, Kari Lake.

Zyrtarët elektoralë në qarkun Maricopa thonë se makineritë e votimit nuk janë të lidhura në internet dhe transmetojnë drejtpërdrejt procesin zgjedhor dhe numërimin e fletëvotimeve.

“Përveç sigurimit fizik, ne kemi edhe siguri shtesë në qendrat e votimit, te bordet dypartiake, vëzhguesit e partive politike dhe gjatë gjithë procesit, që të sigurohemi se çdo fletëvotim është llogaritur dhe që të numërohen vetëm votat e vlefshmet”, thotë Megan Gilbertson nga departamenti i zgjedhjeve në qarkun Maricopa.

Votuesja Mirian Mitchell thotë se këto zgjedhje nuk janë të rëndësishme vetëm për të ardhmen e Kongresit. “Ndonjëherë fitojmë, ndonjëherë humbasim. Kur humbasim, urojmë që të kishim fituar, por gjithsesi respektojmë proceset demokratike. Ne e dorëzojmë pishtarin, siç edhe duhet të bëjmë... Kjo është e mrekullueshme në Amerikë. Ky është procesi ynë demokratik. Duhet ta ruajmë atë”, thotë ajo. Në Arizona tashmë kanë filluar votime e hershme.

Rasti Thaçi dhe të tjerët, gjykatësi: Çështja do të kalojë te trupi gjykues para fundit të vitit



HAGË, 4 NËNTOR - Në Dhomat e Specializuara të Kosovës në Hagë është mbajtur konferenca e 15 për ecurinë e çështjes së ish-krerëve të UÇK-së, Hashim Thaçi, Kadri Vesli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi. Gjykatësi i procedurës paraprake në Gjykatën Speciale, Nicolas Guillou, i ka njoftuar palët se përpara fundit të këtij viti synon që çështjen e Thaçit, të Veselit, të Krasniqit dhe të Selimit t'ia dorëzojë trupit gjykues.

"Para se t'ju jap fjalën palëve që t'ia paraqesin pikëpamjet për secilën pikë të rendit të ditës, konfirmoj se synoj t'ia kaloj çështjen trupit gjykues përpara fundit të vitit. Synoj të marr vendim mbi kërkesat që më janë paraqitur deri tani për shqyrtim, por jo për kërkesa jorgjente të

cilat palët do t'i dorëzojnë nga dita e sotme deri në kalimin e çështjes së trupit gjykues, për të mos vonuar procedurat", ka thënë gjykatësi i procedurës paraprake.

Gjykatësi Guillou ka thënë se lidhur me materialin shfajësues mbrojtja ka ngritur shqetësimin e nxjerrjes me vonesë nga prokuroria. Sipas tij, mbrojtja ka përmendur dy paketa të nxjerra shtesë të nxjerra më 1 dhe 24 tetor 2022 që përmbajnë një sërë materiale shfajësuese dhe se mbrojtja ka bërë me dije se shumica e tyre kanë qenë në zotërim të Zyrës së Prokurorit të Specializuar (ZPS) për një kohë të konsiderueshme. Ai ka thënë se kanë kërkuar të bëhet konstatim i shkeljeve për ZPS-në për mospërmbushje të obligimeve dhe të rivendoset një

afat për ZPS-në për ta finalizuar vlerësimin e materialit shfajësues brenda një muaji.

Avokati Gregory Kehoe, që mbron Thaçin, ka theksuar se nxjerrja e këtyre materialeve është bërë me vonesë pavarësisht prej qortimeve të gjykatësit se duhet të bëhet nxjerrja menjëherë. "Nuk di si ta rregullojmë këtë me përjashtim të ndonjë sanksioni që mund të vendoset sepse ka një sërë dokumentesh që vazhdojnë të na dorëzohen", ka thënë Kehoe. Ai ka shtuar se ZPS-ja ka rivendosur dëshmitarët dhe e dinë se edhe në nëntor të 2020-s, prokurori i specializuar, Jack Smith, u ka thënë ndërkombëtarëve se ka pasur 37 kërkesa për zhvendosje të dëshmitarëve. Ai ka pohuar se nuk kanë asnjë informacion sa

iu përket kërkesave për zhvendosje të vendbanimit të dëshmitarëve dhe kjo paraqet problem si dhe ka shtuar se ata e dinë se kjo është duke u bërë dhe duhet të jepet urdhër nga gjykata që ZPS-ja t'ia dorëzojë këtë informacion mbrojtjes. Sipas tij, e vetmja gjë që dinë është se Smith u ka thënë ndërkombëtarëve në nëntor të vitit 2020 se ka kërkesa të tilla. Më pas përmbajtja është redaktuar, kurse është kaluar në seancë private kur e ka marrë fjalën avokati i Veselit, Ben Emmerson, pasi ky i fundit ka paraqitur një kërkesë të tillë. Ndryshe, gjykatësi paraprakisht në fillim të konferencës ka deklaruar se synon që dosjen t'ia kalojë trupit gjykues deri në fund të këtij viti.

Zyra e Prokurorit të Specializuar

më 30 shtator ka dorëzuar aktakuzën e konfirmuar të ndryshuar ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit, e cila përbëhet nga dhjetë pika me akuzë, ku këta të fundit ngarkohen për krime lufte e krime kundër njerëzimit, pasi që gjykatësi e kishte aprovuar pjesërisht mocionin e mbrojtjes së Hashim Thaçit, të parashtruar ndaj aktakuzës së ndryshuar në rastin ku ai me Kadri Veselin, Jakup Krasniqin e Rexhep Selimin, po akuzohen për krime lufte dhe ZPS ishte urdhëruar të bëjë ndryshime në aktakuzën e ndryshuar.

Në këtë aktakuzë thuhet se përmes veprimeve dhe mosveprimeve të përshkruara më lart, Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi, kanë kryer përmes pjesëmarrjes së tyre në një ndërmarrje të përbashkët kriminale dhe/ose kanë ndihmuar dhe nxitur krimet e ngarkuara në këtë aktakuzë.

Sipas prokurorisë, krahas kësaj ose në alternativë, Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi janë përgjegjës si eprorë për krimet e kryera nga vartësit e tyre.

Më tutje, aktakuza thotë se Thaçi, Veseli, Selimi dhe Krasniqi e dinin ose kishin arsye të dinin se krimet e akuzuara në këtë aktakuzë ishin gati të kryeshin ose ishin kryer nga vartësit e tyre dhe nuk kishin marrë masat e nevojshme dhe të arsyeshme për parandalimin e krimeve të tilla ose t'i ndëshkojnë autorët e saj.

Zvicrës i kërkohet partneritet migrimi me Kosovën

BERN, 4 NËNTOR - Drejtori i Zyrës Ligjore 'First-consulting', njëherësh edhe drejtor i 'Zërit Perëndimor të Kosovës', Sali Bislimi, i shoqëruar edhe nga bashkëpunëtori i tij, avokati Marcel Ryser, janë pritë në Bern në një takim nga zëvendëssekretari i shtetit në migracionin Federal SEM, Mario Martelli. "Sot së bashku me bashkëpunëtorin tim, avokatin z. Marcel Ryser, u pritëm në Bern nga zëvendëssekretari i shtetit, Mario Martelli (SEM). I përkushtuar për raportet e mira mes shteteve tona dhe një komuniteti të madh shqiptar këtu, theksuam se është domosdoshmëri e kohës që të afrohem edhe më shumë nëpërmjet punës. Shqiptarët sot e bëjnë Zvicrën edhe më të pasur dhe një partneritet migrimi do ta shpëtonte Kosovën dhe do ta ndihmonte Zvicrën sidomos në lëmin e ndërtimit, ku shqiptarët bëjnë punën më të madhe.

Morëm dritën e gjelbër se do të punohet në këtë drejtim", ka bërë me dije Bislimi.

Ai ka treguar se në këtë takim kanë biseduar në përgjithësi për gjërat që lidhen me komunitetin shqiptar në Zvicër. "Si zyrë ligjore e specializuar në çështjet e migracionit ngritëm shumë shqetësime me të cilat përballlemi çdo ditë. Bisedova për të gjitha çështjet, edhe për politika gjeostrategjike të vendit tonë, ku Zvicra mund të luajë një rol të rëndësishëm në rrjedhat demokratike pro perëndimore", ka thënë Bislimi, duke shtuar se ishte një mikpritje vëllazërore nga zëvendëssekretari i shtetit zviceran, i cili ka premtuar se gjërat do të zhvillohen në drejtimin e duhur për interesin e të dyja vendeve. "Atdheu ynë i dytë, Zvicra, meriton respektin. Si komb i sfiduar në histori i jemi mirënjohës sa të ekzistojë njerëzimi", ka deklaruar Bislimi pas takimit.





Mbrojtja e Thaçit zbulon identitetin e tetë dëshmitarëve ndërkombëtarë

Në mesin e dëshmitarëve që mbrojtja e Hashim Thaçit dëshiron të thërrasë për dëshmi janë ish-diplomatë dhe ish-zyrtarë të lartë të NATO-s. Në listën e paraqitur të dëshmitarëve përfshihen: Wesley Clark, William Walker, Bernard Kouchner, Daan, W. Everts, Michael Durkee, Jock Covey dhe Steve Bennett

Hagë, 4 nëntor - Ekipi mbrojtës i ish-presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi, përmes një mocioni të dërguar gjykatës të procedurës paraprake, ka treguar se janë tetë dëshmitarë ndërkombëtarë që planifikon të ftojë në gjykimin pranë Dhomave të Specializuara në Hagë. Mbrojtja po kërkon që dëshmitë e këtyre dëshmitarëve të mund të "ruhen" para se të nisë gjykimin.

Thaçi, si ish-udhëheqës i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, bashkë me ish-eprorët e tjerë, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi e Rexhep Selimi, ndodhen në paraburgim në Hagë që nga nëntori i vitit 2020.

Ata akuzohen për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit.

Në listën e paraqitur të dëshmitarëve përfshihen: Wesley Clark, William Walker, Bernard Kouchner, Daan, W. Everts, Michael Durkee, Jock Covey dhe Steve Bennett. Në këtë listë është edhe një dëshmitar i Zyrës së Prokurorit të

Specializuar, emri dhe të dhënat e të cilit janë redaktuar.

Kush janë dëshmitarët e mbrojtjes?

Clark, 77 vjeç ka qenë komandant suprem i NATO-s në Evropë dhe komandant i komandës evropiane të Shteteve të Bashkuara nga viti 1997 deri në maj të vitit 2000.

Kouchner, që, po ashtu, është në listën e dëshmitarëve që mbrojtja synon të thërrasë, ka qenë përfaqësues i posaçëm i sekretarit të përgjithshëm në misionin e UNMIK-ut nga korriku i vitit 1999 deri në janar të vitit 2001.

Walker ka qenë drejtues i Misionit Vëzhgues të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) për Kosovën nga tetori i vitit 1998 deri në mesin e qershorit të vitit 1999.

Bennett ka qenë drejtor i Departamentit për Politika të Edukimit dhe Zhvillimit në

OSBE nga viti 1996 deri më 2006.

Covey ka qenë zëvendës drejtues i UNMIK-ut nga viti 1999 deri më 2001.

Durkee ka qenë këshilltar politik i Clarkut nga viti 1998 deri më 1999. Ndërkaq, Everts ka drejtuar zyrën e OSBE-së në Tiranë dhe më pas atë në Prishtinë më 1999. "Tetë dëshmitarët gjatë kohës për të cilën është ngritur aktakuza kanë qenë diplomatë të lartë ndërkombëtarë, administratorë, figura ushtarake në pozita të larta në NATO, në Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë [OSBE], në Kombet e Bashkuara, në Administratën e Përkohshme të OKB-së në Kosovë [UNMIK] dhe në Misionin Vëzhgues në Kosovë. Që të gjithë kanë pasur ndërveprime me Thaçin si në aspektin profesional, por në disa raste edhe në atë personal", thuhet në mocionin e mbrojtjes. Mocioni i mbrojtjes i Thaçit ka të bëjë me "mundësitë unike hetuese", duke kërkuar që gjykata ta lejojë mbrojtjen që t'i "ruajë" dëshmitë e këtyre dëshmitarëve, nëse ata nuk do të mund të paraqiten fizikisht në gjykatë për të dëshmuar. Mbrojtja tha se këta dëshmitarë mund të ofrojnë dëshmitë e tyre para se të nisë gjykimin dhe se dhënia e këtyre dëshmime mund të "vëzhgohet" edhe nga Paneli

Gjykes. "Të tetë dëshmitarët janë në moshë të shtyrë, nga 77 deri në 88 vjeç dhe kanë sëmundje të ndryshme. Për mbrojtjen është ideale që t'i thërrasë këta dëshmitarë gjatë paraqitjes së rastit të saj [pasi Zyra e Prokurorit të Specializuar ta ketë përfunduar paraqitjen e rastit të saj] dhe ata do të dëshmonin sikurse të gjithë dëshmitarët e tjerë. Por, për shkak të moshës së tyre të shtyrë, ka rrezik real që dëshmia e tyre 'mund të mos jetë e qasshme gjatë gjykimin', ose në kohën kur Prokuroria t'i përfundojë argumentet e saj dhe mbrojtja ta nisë paraqitjen e rastit të saj, qoftë për shkak të vdekjes apo edhe për shkak të kufizimeve për shkak të moshës", argumenton mbrojtja e Thaçit.

Mbrojtja e Thaçit ka thënë se ka humbur dy dëshmitarë potencialë: ish-sekretaren amerikane të Shtetit, Madeleine Albright, që vdiq në moshën 84-vjeçare, dhe ish-diplomatit amerikan, që vdiq më 2010 në moshën 69-vjeçare, Richard Holbrooke. "Këta shembuj tregojnë nevojën reale të ruajtjes së dëshmimeve të këtyre tetë individëve", ka thënë mbrojtja.

Mbrojtja e Thaçit ka treguar se Zyra e Prokurorit të Specializuar ka thënë se do t'i duhen 709 orë për të parashtruar pyetje për

dëshmitarët që do të thërrasë në gjykim. Duke argumentuar se një kohë e njëjtë do t'i jepej edhe asaj për këtë çështje, mbrojtja e ish-presidentit të Kosovës ka thënë se për t'i përfunduar dëshmitë e dëshmitarëve të Prokurorisë, do të duhen 1 418 orë. "Nëse gjykata punon katër ditë në javë, gjashtë orë në ditë, Zyrës së Prokurorit të Specializuar do t'i duhen minimum 236 ditë për t'i dëgjuar dëshmitë e dëshmitarëve të saj dhe 66 ditë do t'i duheshin mbrojtjes për t'u parashtruar pyetje këtyre dëshmitarëve", thuhet në mocion.

Rasti ndaj Thaçit dhe ish-eprorëve të tjerë është ende në procedura parajgyqësore dhe nuk ka ndonjë datë për nisjen e gjykimin.

Gjykata Speciale, me seli në Hagë, synon t'i hetojë krimet e pretenduara të ish-anëtarëve të UÇK-së të kryera kundër pakicave etnike dhe kundërshtarëve politikë nga janari i vitit 1998 deri në dhjetor të vitit 2000. Këto pretendime janë përmendur për herë të parë në një raport të Këshillit të Evropës të hartuar nga senatori i atëhershëm zviceran, Dick Marty. Ky raport, në fakt, i ka hapur rrugë themelimit të Gjykatës Speciale përmes një vendimi të Kuvendit të Kosovës në vitin 2015.

Scholz: Me Francën po i shtyjmë Kosovën dhe Serbinë drejt marrëveshjes

BERLIN, 4 NËNTOR - Kancelari i Gjermanisë, Olaf Scholz, ka konfirmuar se ekziston plani franko-gjerman, që është raportuar se është një propozim për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis Kosovës dhe Serbisë.

“Sa i përket Kosovës dhe Serbisë, atje duhet të gjendet një mirëkuptim. Ne dhe qeveria franceze jemi duke u munduar ta

bëjmë të arritshme, të realizueshme dhe shpresoj që shumë shpejt të kemi një proces ku të dy qeveritë do të ecin përpara dhe do të arrijnë një marrëveshje”, ka theksuar Scholz në një konferencë të përbashkët për medie me kryeministrin e Shqipërisë, Edi Rama, pas Samitit të Procesit të Berlinit.

Scholz nuk ka dhënë detaje të këtij

plani, për të cilin kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, dhe presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, e kanë konfirmuar se kanë njohuri.

Edhe kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka refuzuar të japë detaje mbi planin franko-gjerman, duke insistuar se “është respekt ndaj ndërmjetësit të ruhet konfidencialiteti i bisedimeve

konkrete”. Por, ai ka thënë se do të pranojë çfarëdo propozimi që bazohet në “vlera evropiane dhe demokratike” dhe që nuk cenon integritetin dhe sovranitetin e Kosovës.

Sa i përket marrëveshjes finale në mes të Kosovës dhe Serbisë, Kurti ka insistuar që Kosova do të pranojë një marrëveshje të tillë vetëm nëse përfshihet njohja

reciproke mes dy vendeve. “Është herët të themi tani se çfarë do të përmbajë ajo në fund. Marrëveshja e ardhshme ndërmjet Kosovës dhe Serbisë duhet të jetë finale, duhet të jetë për normalizimin të plotë, duhet të jetë ligjërishit e obligueshme dhe patjetër ta ketë njohjen reciproke në qendër”, ka deklaruar Kurti.



Samiti i ardhshëm midis BE-së dhe Ballkanit Perëndimor, më 6 dhjetor në Tiranë

TIRANË, 4 NËNTOR - Të enjten Shqipërisë i është dhënë, me propozimin e kancelarit gjerman Olaf Scholz, kryesimi i Procesit të Berlinit dhe organizimi në Tiranë i Samitit të ardhshëm. Kryeministri Edi Rama ka bërë me dije se më 6 dhjetor në Shqipëri do të mbahet i pari Samit i Bashkimit Evropian me Ballkanin Perëndimor në rajonin tonë. “Këto ngjarje të mëdha ndërkombëtare të pandodhura kurrë më parë në Shqipëri, të paimagjinueshme deri disa kohë më parë për t’iu besuar një qeverie të Shqipërisë, janë domethënëse për shkallën e respektit që Shqipëria ka fituar ndërkombëtarisht”, ka thënë

Rama, duke shtuar se Shqipëria mbetet një vend i vogël, me hallet e problemet që duan kohën, durimin e punën për t’u zgjidhur. “Ne sot kemi fituar respekt duke u dhënë të gjithëve respekt, por edhe duke kërkuar respekt nga të gjithë. Lutem çdo ditë që të gjithë ne, shqiptarët, në radhë të parë ata që komunikojnë me botën, politikanë, gazetarë, artistë, sportistë e të tjerë, ta mësojmë nga popuj të tjerë pa humbur akoma kohë të pafundme, se Shqipëria është shtëpia jonë, që nuk shahet kurrë në gjuhë të huaj, por vetëm mbrohet e promovohet për një mijë e një të mirat e saj”, është shprehur Rama.



Respektimi i sovranitetit dhe integritetit territorial të Ukrainës



Ambasadori Jeffrey M. HOVENIER

Gjatë forumit të Grave, Paqes dhe Sigurisë të mbajtur në Prishtinë para disa javësh, iu bashkova duartrokitjeve të qindra pjesëmarrësve kur presidentja Osmani i dekoroi gratë e Ukrainës me Medaljen Presidenciale të Meritave. Të gjithë u prekëm nga fjalët e deputetes së Parlamentit të Ukrainës, Yevgenia Kravchuk, e cila e pranoi këtë medalje në emër të tyre. Znj. Kravchuk rrëfeu se si sulmi brutal, i pajustificueshëm i presidentit Putin ka prekur - dhe vazhdon të prekë - jetët e të gjithëve në Ukrainë. Ajo i përshkroi sulmet e tmerrshme ajrore në qytetet paqësore të Ukrainës dhe se si fëmijët ukrainas po rriten në kohë lufte - në vend se të shkojnë në shkollë, ata zgjedhen për të shkuar në strehimore nga bombardimet. Në fakt, znj. Kravchuk vuri në pah se në çastin kur po fliste para nesh në Prishtinë, vajza e saj ishte në strehimore për tu mbrojtur nga sulmet ajrore.

Pushtimi i Rusisë dhe agresioni i vazhdueshëm ka shkakuar pasoja të tmerrshme te aq shumë njerëz. Ne do të vazhdojmë të mbrojmë sovranitetin e Ukrainës në Kombet e Bashkuara dhe të ofrojmë mbështetje për popullin e Ukrainës përdërisa Rusia po bën gjithçka në fuqinë e saj për ta minuar atë sovranitet: dëbime të

detyruara dhe operacione "filtrimi", vrasjen pa gjyq të civilëve, kërcënime të vazhdueshme ndaj jetëve dhe mjeteve të jetesës, dhe instalim të satelitëve rusë. Dhe ne do të vazhdojmë të punojmë me aleatët dhe partnerët tanë për të imponuar kosto Rusisë.

Shtetet e Bashkuara mirëpritën dënimin e shpejtë të Kosovës të pushtimit të paprovokuar dhe të pabazë të Kremlinit dhe shprehjen e solidaritetit të plotë me popullin e Ukrainës. Kosova i hapi dyert për ukrainasit që gjetën strehim këtu, përfshirë gazetaret ukrainase që tani banojnë në Kosovë, shumë prej të cilave ishin në skenë për të pranuar medaljen nga Presidentja Osmani. Këto gazetarë vazhdojnë që me trimëri të bëjnë të mundur që njerëzit anembanë botës kanë qasje në informata të besueshme dhe të sakta për atë që po ndodh në Ukrainë.

Kosova gjithashtu menjëherë u rreshtua me sanksionet e SHBA-së dhe BE-së në mbështetje të Ukrainës. duke shfaqur sërish përkushtimin e saj për të qenë pjesë e botës së demokracive të lira dhe sovra.

Përkushtimi ynë ndaj Ukrainës është i hekurt. Veprimet e Kremlinit në Ukrainë paraqesin sulm të drejtpërdrejtë ndaj Kartës

së OKB-së dhe parimeve të saj kryesore: sovraniteti, integriteti territorial, paqja dhe siguria për të gjitha shtetet - të mëdha e të vogla. Shtetet e Bashkuara dhe partnerët e aleatët tanë i kanë mbështetur prej kohësh këto parime, të cilat janë themeli i rendit ndërkombëtar të ndërtuar dhe mbështetur nga vende anembanë botës që nga fundi i Luftës së Dytë Botërore. Duke i sfiduar këto parime, Rusia kërkon të minojë vetë sistemin ndërkombëtar.

Presidenti Biden ka thënë: "Bota ka dërguar porosi të qartë: Rusia nuk mund ta fshijë një shtet sovran nga harta. Rusia nuk mund t'i ndryshojë kufijtë me forcë. Rusia nuk mund të kapë territorin e një vendi tjetër si të vetin".

Referendumet e fundit fiktive të Kremlinit nuk ishin gjë tjetër veçse pretekst i remë për të tentuar aneksimin e pjesëve të Ukrainës me forcë. Këto dredhi propagandistike ishin tentim për të maskuar përpjekjen e kotë të Rusisë për të rrëmbyer tokë në Ukrainë. "Rezultatet" u sajuan në Moskë - ato nuk u mblodhën në Ukrainë dhe ato tregojnë vullnetin e Moskës, jo vullnetin e lirë të Ukrainës dhe popullit të saj. Rusia i detyroi qytetarët e Ukrainës, të bllokuar nga ushtria ruse, për të votuar nën tytat e pushkëve. Më 30 shtator, Rusia u përpoq të

mbrohej nga llogaridhënia dhe përgjegjësia duke vënë veton në rezolutën e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara që dënonte të ashtuquajturat "referendume" dhe përpjekjet për aneksim. Por, Rusia ishte e izoluar - asnjë vend i vetëm nuk votoi krah Rusisë.

Ne kurrë nuk do t'i njohim këto zona si pjesë të ndonjë vendi tjetër përveç Ukrainës dhe do ta mbështesim Ukrainën për aq kohë sa të duhet. Ndërsa Ukraina rifiton kontrollin mbi më shumë territor të saj dhe përdërisa dalin në shesh pasojat e tmerrshme në njerëz nga agresioni i Rusisë, Kremlini po nxiton dëshpërimisht të largojë vëmendjen e botës nga humbjet e tij ushtarake dhe krimet e luftës.

Veprimet e presidentit Putin vetëm se e kanë izoluar më tej Rusinë dhe kanë forcuar vendosmërinë ndërkombëtare për të qëndruar përkrah Ukrainës. Kërcënimi i tij me shpërthim bërthamor, referendumet e rreme, mobilizimi i detyruar dhe shtypja e gjerë dhe ndonjëherë e dhunshme - e rusëve që ushtrojnë të drejtat e tyre për t'u shprehur kanë elektrizuar publikun, por jo në mënyrën që ai synonte.

Në reagim, Shtetet e Bashkuara dhe aleatët dhe partnerët tanë, përfshirë Kosovën, po vendosin

kosto të shpejtë dhe të rëndë që synojnë zyrtarët e qeverisë ruse, anëtarët e familjeve të tyre, zyrtarët ushtarakë rusë dhe bjellorusë dhe rrjetet e prokurimit të mbrojtjes, duke përfshirë furnizuesit ndërkombëtarë që mbështesin kompleksin ushtarako-industrial të Rusisë. Nga kufizimet për viza e deri te sanksionet, veprimet nga e tërë qeveria e SHBA-së vazhdojnë t'i shtojnë masat e gjera ekonomike të vendosura ndaj Rusisë për t'i kërkuar përgjegjësi për luftën e paprovokuar në Ukrainë.

Populli i Ukrainës, publikisht dhe vazhdimisht, ka shprehur dëshirën e tij për të ardhme të lirë dhe demokratike. Ata janë të vendosur të mbesin të pavarur dhe sovran. Ukrainasit po luftojnë trimërisht. Ata po luftojnë dhe po iu bëjnë ballë përpjekjeve të Rusisë për të ndryshuar me forcë brutale kufijtë e njohur ndërkombëtarisht të Ukrainës.

Ne do të vazhdojmë të qëndrojmë bashkë me partnerët tanë, përfshirë Kosovën, në mbrojtjen e parimeve thelbësore të Kartës së OKB-së. Dhe do të vazhdojmë të ndihmojmë popullin e Ukrainës dhe t'i ofrojmë mbështetje për t'i ndihmuar ata të mbrojnë veten dhe territorin e tyre kundër pushtimit të paligjshëm të Rusisë.

Abazi: Procesi i Berlinit, më i rëndësishmi këtë vit

PRISHTINË, 4 NËNTOR - Kryetari i Komisionit për Punë të Jashtme dhe Diasporë, Haki Abazi, e ka cilësuar procesin e Berlinit dhe marrëveshjet e arritura në kuadër të tij si më të rëndësishmet për Kosovën gjatë këtij viti. Ai ka theksuar se Kosova duhet të veprojë mençur, sepse ky proces e orienton Kosovën drejt BE-së. "Procesi i Berlinit dhe marrëveshjet shënojnë momentin më të rëndësishëm të vitit 2022. Është një orientim



drejt vlerave euroatlantike në BE", ka thënë Abazi në një konferencë për medie të premtën, duke shtuar se kjo

agjendë euroatlantike është e vetmja që fitojnë qytetarët. "Procesi i Berlinit i ka treguar Ballkanit se ka të bëjë me

gjashtë shtete të barabarta dhe se nuk ka kushtëzime. Për këtë duhet t'i falënderohemi shtetit gjerman. Shpresoj që ratifikimi të bëhet në vendet e Ballkanit dhe të zbatohen në mënyrë konkrete edhe pse mund të ketë vonesa", ka thënë Abazi.

Liderët e Kosovës, të Shqipërisë, të Bosnjë-Hercegovinës, të Malit të Zi, të Maqedonisë së Veriut dhe të Serbisë kanë nënshkruar tri marrëveshje për njohjen reciproke të letërnjoftimeve, të

diplomave universitare dhe të kualifikimeve profesionale në kuadër të samitit të Procesit të Berlinit që është mbajtur një ditë më parë. Marrëveshjet e nënshkuara pas gati dy vjet negociatash fillimisht duhet të ratifikohen para se të hyjnë në fuqi, ka njoftuar Qeveria e Kosovës. Marrëveshja për njohjen reciproke të letërnjoftimeve mundëson lëvizjen e lirë, pa viza, në mes të Kosovës dhe Bosnjë-Hercegovinës.

PËRFUNDUAN PUNIMET E TAKIMIT TË NËNTË TË KOMISIONIT PARLAMENTAR PËR STABILIZIM ASOCIIM BE - KOSOVË

Liberalizimi i vizave për Kosovën duhet të trajtohet urgjentisht

Deputeti i Parlamentit Evropian, Romeo Franc, para parlamentarëve në Kuvendin e Kosovës, ka bërë të qarta qëndrimet e institucionit që përfaqëson në aspektin e integritetit të Kosovës në BE. Gjatë fjalimit të tij ai u fokusua tek arritjet Kosovës dhe detyrat e përmbushura deri tani të cilat kërkohen nga BE-ja. Sipas Franc, Kosova tashmë është gati edhe për liberalizimin e vizave. "Situata me vizat duhet të trajtohet urgjentisht", ka theksuar Franc

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

Prishtinë, 4 nëntor - Ka përfunduar punimet takimi i nëntë i Komisionit Parlamentar për Stabilizim Asociim BE - Kosovë i cili është mbajtur në Prishtinë në ambientet e Kuvendit të Kosovës. Në sesionin e dytë të këtij takimi është votuar deklarata e përbashkët me rekomandimet e Komisionit Parlamentar për Stabilizim Asociim BE - Kosovë drejtuar Këshillit të Stabilizim Asociimit dhe institucioneve të Kosovës dhe Bashkimit Evropian.

Punimet e këtij takimi janë drejtuar nga dy deputetët bashkëkryesues, Mimoza Kusari-Lila nga Kuvendi i Kosovës dhe Romeo Franz nga Parlamenti Evropian. Në fjalën e saj hyrëse, deputetja Kusari - Lila, duke e cilësuar shumë të rëndësishëm punën e këtij komisioni, ka theksuar se në këtë takim do të zhvillohen diskutime të frytshme sa i përket zhvillimit të marrëdhënieve Kosovë - BE.

Ajo ka shtuar se meqë MSA-ja është marrëveshja e parë kontraktuale në mes të Kosovës dhe BE-së, shteti i Kosovës ndan vlera të njëjta demokratike me shtetet anëtare të Bashkimit Evropian, siç është shteti i së drejtës, transparencës, respektimit të drejtave të njeriut, mediet e lira, ndonjëse qytetarët e Kosovës ende privohen nga e drejta për lëvizje të lirë. "Kuvendi i Kosovës sfidohet sa herë që kërkohet pjesëmarrja e deputetëve të komunitetit serb në seanca plenare. Bojkotimi i punimeve nga ana e përfaqësuesve të komunitetit serb, i cili ndodh në vazhdimësi, është i qëllimshëm dhe ka ndikuar që nga ky Kuvend të mos procedohen shumica e projektligjeve ku kërkohet edhe pjesëmarrja në votim prej anës së tyre", ka theksuar Kusari-Lila.

Deputeti i Parlamentit Evropian, Romeo Franc, para parlamentarëve i ka bërë të qarta qëndrimet e institucionit që ai përfaqëson në aspektin e integritetit të Kosovës në BE. Gjatë fjalimit të tij, ai është fokusuar tek arritjet Kosovës dhe detyrat e përmbushura deri tani të cilat



kërkohen nga BE-ja. Sipas Franc, Kosova tashmë është gati edhe për liberalizimin e vizave. "Situata me vizat duhet të trajtohet urgjentisht dhe unë besoj që në të ardhmen e afërt qytetarët e Kosovës do të lëvizin lirshëm ashtu siç e meritojnë", ka theksuar ai.

Për më tepër, Franc shprehu qëndrimet e Kosovës për situatën Rusi - Ukrainë. Ai ka thënë se këto janë shumë të qarta dhe pro qëndrimeve euroatlantike.

Eurodeputeti Franc ka thënë se BE-ja do të vazhdojë ta mbështesë Kosovën deri në arritjen e qëllimit të përbashkët - anëtarësimin në këtë organizatë. Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, duke i uruar deputetët e të dy komisioneve për punën e bërë tash e disa vjet, ka thënë se, bazuar edhe në rekomandimet e dala nga puna intensive e të dy komisioneve, Kosova ka arritur të shënojë përparim të madh në rrugën e saj drejt Bashkimit Evropian.

Për rrjedhojë, sipas Konjufcës, edhe dizajnimin e politikave të shtetit tonë është bërë në frymë të plotë me rekomandimet nga punimet e këtij komisioni, po ashtu edhe nga rekomandimet e Komisionit Evropian për Kosovën. "Republika e Kosovës dhe Kuvendi në veçanti, me punën, përkushtimin dhe kontributin e tyre, kanë dëshmuar përafrim dhe bashkërendim të politikave me ato të Bashkimit Evropian", është shprehur Konjufca.

Kreu i Kuvendit ka rikujtuar qëndrimin e Kosovës në mbështetje të Ukrainës, ndërsa ka tërhequr vëmendjen për politikën destabilizuese të Serbisë në rajon, veçanërisht në raport me Kosovën, ndër të tjera, duke grumbulluar edhe trupa ushtarake pranë kufijve të saj. Më pas, në emër të qeverisë, fjalën e ka marrë ministri i Administrimit të Pushtetit Lokal, Elbert Krasniqi.

Gjatë adresimit të tij, ministri Krasniqi ka numëruar kushtet që

i Kosova ka plotësuar, ashtu siç edhe ka kërkuar BE-ja ndër vite. "Kosova, ashtu sikurse shtetet e tjera fqinje, ka përmbushur të gjitha kushtet e BE-së. Vendi ynë ka qëndruar shumë gjatë jashtë agjendës së Bashkimit Evropian. Përkundër që kemi popullsinë me moshën më të re dhe pro BE-së, Kosova tashmë dhjetë vjet mbetet vend i izoluar, pa të drejtë dhe në mënyrë diskriminuese", ka pohuar Krasniqi.

Shefi i Zyrës së BE-së/Përfaqësuesi Special i BE-së në Kosovë, Tomas Szunyog, fjalimin e tij drejtuar deputetëve të këtij komisioni e ka filluar duke theksuar se Evropa nuk është e kompletuar pa Kosovën. Duke u thirrur në të gjeturat e Raportit të Komisionit Evropian, Szunyog ka ritheksuar edhe një herë domosdoshmërinë e implementimit të të gjitha rekomandimeve që janë nxjerrë nga KE.

Takimit i kanë kontribuar edhe pjesëmarrësit e tjerë. Gjatë diskutimeve, në cilësinë e

zëvendëskryetares së Komisionit për Integrim Evropian, Arbëreshë Kryeziu-Hyseni ka thënë se Kosova, pavarësisht prej të gjitha sfidave në vitet e fundit, madje edhe situatës së rënduar me pandeminë, ka qëndruar demokratike dhe transparente. Ajo ka thënë se raporti i Komisionit Evropian e nxjerrë Kosovën pozitivisht ngaqë, sipas saj, Kosova ka shënuar përparim në sundim të ligjit, transparencë, medie të lira, luftim të krimit dhe korrupsionit, rritje të eksportit, investime të huaja etj.

Në pjesën e fundit të takimit punimet kanë vijuar me panelet e diskutimit lidhur me përparimin e arritur në procesin e integritetit evropian, të drejtat themelore me fokus te komunitetet joshumicë, të drejtat e grave dhe dhunën ndaj tyre, sundimin e ligjit, luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, shoqërinë civile dhe mediet, krizën energjetike, kujdesin shëndetësor dhe mjedisin, si dhe të drejtat e fëmijëve dhe respektimin e tyre.

Për nëntë muaj në Klinikën Infektive u trajtuan rreth 2 000 pacientë

PRISHTINË, 4 NËNTOR - Nga janari deri në shtator të këtij viti në Klinikën Infektive të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës

janë trajtuar 1 910 pacientë, prej tyre 556 pacientë me Covid-19.

Brenda këtyre nëntë muajve

janë regjistruar 8 584 vizita në Ambulanten e Pranimit dhe 3 166 vizita në ambulanta specialiste.

Gjatë kësaj kohe, sipas raportit të punës, janë realizuar edhe 2 043 konsultime, 630 echo të abdomenit dhe 387 elastografi.



Të hyrat tatimore arrijnë shifrën 623.6 milionë euro

PRISHTINË, 4 NËNTOR - Trendi rritës i të hyrave vazhdon ta dominojë inkasimin edhe për periudhën janar - tetor 2022, ku përtej planit jemi për 12.9 milionë euro apo 2.1 për qind, përderisa vlera totale e inkasimit shkon në 623.6 milionë euro tatime, Ka njoftuar Administrata Tatimore e Kosovës (ATK). Në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, ka rritje për 111.1 milionë euro

apo 21.7 për qind. Sipas këtij njoftimi, performanca e të hyrave vazhdon të jetë jashtëzakonisht e lartë pavarësisht prej rishikimit të bërë të planit deri në fund vitit. Po ashtu, vlen të theksohet se kjo rritje ka ndodhur pa pasur ndryshim të normave tatimore. Vlerësim për rritje dyshifrore të të hyrave së fundi ATK-ja ka marrë edhe raportet

ndërkombëtare, si ai nga Komisioni Evropian dhe PEFA. Në këto raporte theksohet se përparim i mirë është bërë gjatë periudhës raportuese në lidhje me mbledhjen e tatimeve, ku të ardhurat e përgjithshme për vitin fiskal 2021 ishin 19 për qind më të larta se në vitin 2020 (të hyrat e përgjithshme janë nga ATK-ja dhe Dogana).



Rizvanolli diskuton me sektorin privat lidhur me sigurinë e furnizimit me energji

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 4 NËNTOR - Për të diskutuar lidhur me sigurinë e furnizimit me energji, tarifën e energjisë, rritjen e efikasitetit energjetik, por edhe potencialet për energji të ripërtërishme, Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë ka organizuar një forum diskutimi me temën "Çfarë dimri na pret sa i përket furnizimit me energji?", në të cilën, përveç përfaqësuesve të ndërmarrjeve private, morën pjesë edhe aktorë institucionale përgjegjës për çështjet energjetike.

Ministrja e Ekonomisë, Artane Rizvanolli, ka thënë se konsumatorët në Kosovë duhet të kontribuojnë për shmangien e skenarëve më të këqij të mungesës së energjisë. Ajo ka theksuar se objektivat kryesore të institucioneve të vendit përfshijnë reduktimin e konsumit të përgjithshëm përmes stimulimit të kursimit të energjisë dhe rritjes së efikasitetit energjetik.

Ministrja Rizvanolli ka thënë se lufta në Ukrainë ka ndikuar që tërë kontinenti evropian, përfshirë edhe shtetet anëtare të Bashkimit Evropian, të ballafaqohen me situatë të pasigurt për sa i përket furnizimit me energji elektrike. Ajo ka paralajmëruar edhe shpalljen e ankandeve në muajt në vijim për dhënie të licencave për kompanitë e interesuara për gjenerim të



energjisë elektrike nga burimet e diellit dhe erës.

Kryetari i Bordit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë (ZRRE), Ymer Fejzullahu, ka rikujtuar vendosjen e tarifave të reja të energjisë në shkurt të këtij viti dhe mosngritjen e tarifave për bizneset, duke e vlerësuar atë si një vendim të drejtë, pavarësisht prej kundërshtimeve të mëdha. Ai ka theksuar se ZRRE-ja vazhdon të insistojë në

realizimin e të gjitha investimeve të parapara kapitale edhe në infrastrukturën e transmissioinit dhe atë të furnizimit. Fejzullahu ka paralajmëruar edhe lehtësimin e kriterëve sa i përket licencimit të kapaciteteve gjeneruese për qëllime të vetëkonsumit. Ai ka folur edhe për nevojën e përmbylljes së liberalizimit të tregut të energjisë, duke theksuar përfitimet të cilat do

t'i kishin konsumatorët nga kalimi në treg të lirë.

Mimozë Veliu, analiste e Ekonomisë Qarkore në Programin e Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara (UNDP), ka theksuar rëndësinë e fokusimit në aktivitete të ekonomisë qarkore, përfshirë edhe trajtimin sistematik të mbeturinave, duke ndikuar kështu edhe në aspektin ekologjik, por edhe në krijimin

e kapaciteteve të reja energjetike.

Ilir Ibrahim, përfaqësues i sektorit privat, shprehu shqetësimin e tij për furnizimin me energji për këtë dimër të ardhshëm. Ai ka shtuar se furnizimi me energji është padyshim në rrezik dhe se institucionet urgjentisht duhen ta adresojnë kërkesën e madhe, duke u fokusuar edhe në diversifikimin e burimeve të energjisë.

Vihet gurthemeli i qendrës për magazinimin dhe ruajtjen e prodhimeve bujqësore

RAHOVEC, 4 NËNTOR - Po përmbushet edhe një premtim publik i kryetarit të komunës së Rahovecit, Smajl Latifi. Të premtën ka nisur realizimi i një projekti shumë të rëndësishëm për bujqit në këtë komunë, ndërtimi i Qendrës për

Magazinimin dhe Ruajtjen e Prodhimeve Bujqësore (depos bujqësore). Kryetari Latifi ka thënë se ndërtimi i kësaj qendre do të bëhet me kushte dhe standarde bashkëkohore dhe do të ketë shtatë njësi (shtatë dhoma ftohëse). "Tri

prej tyre do të jenë edhe për ngrirje të thellë dhe energjia për to do të sigurohet edhe nga panelet diellore. Padyshim se kjo do t'u shërbejë bujqve tanë që t'i ruajnë të freskëta prodhimet e tyre për një periudhë të caktuar", ka thënë Latifi.



SHKENCA | Zbulime të 'çmendura'



Një mëngjes gushti të vitit 1835, lexuesit e New York Sun u befaskan kur lexuan se Hëna ishte e banuar. Tre të katërtat e faqes së parë të gazetës i dedikoheshin këtij lajmi, i pari i një serie me titull: "Zbulime të mëdha astronomikë të bërë kohët e fundit nga Sir John Herschel në Kepin e Shpresës së Mirë". Herschel, një astronom i mirënjohur britanik, ishte në gjendje që, "përmes një teleskopi me dimensione shumë të mëdha dhe një parim krejtësisht të ri", thoshte gazeta, që të shihje objekte në Hënë sikur këta të ishin "njëqind metra larg". Çdo lajm i ri në serinë me gjashtë pjesë raportonte zbulime më fantastikë se paraardhësi.

Teleskopi i Herschelit zbuloi pyje në Hënë, liqene dhe dete, ametistë monstruoze pothuajse njëqind metra të lartë, kodra të kuqe dhe humnera shumë të mëdha. Këtë panoramë surreale e popullonin kafshë që u ngjanin bizonëve, dhive, pelikanëve, deleve – edhe njëbrirështa. Një amfib në formë topi vinte vërdallë duke rrëshkitur. Kishte drerë brilopartë, arinj me brirë dhe zebra të vogla. Por surpriza më e madhe i përkiste artikullit të katërt të serisë. Herscheli dhe ekipi i tij i astronomëve kishin pikasur humanoidë: krijesa me krahë si lakuriqë nate, katër metra të larta, me fytyra që ishin një "përmirësim i vogël" i orangutangëve. Quajtur Vespertilio-homo, këto krijesa vëreheshin të ishin "të pafajshme", por ato shpesh herë silleshin në një mënyrë që autori mendonte se nuk ishte e përshtatshme për botim. The Sun përshkruante gjithashtu tempuj të mëdhenj, ndonëse gazeta bënte kujdes të thoshte që nuk ishte e qartë nëse këta njerëz fluturoues, apo ishin një paralajmërim për të ardhmen.

Reagimi ndaj kësaj serie varionte nga mosbesimi në habi. Vetë Herscheli ishte i mërzhitur. Në një letër drejtuar hallës së tij, Caroline Herschel, edhe ajo një astronome, ai shkruante: "Jam mërzhitur tej mase nga ai mashtrimi për Hënë – në anglisht, frëngjisht, italisht dhe gjermanisht!" Autori i artikullit me shumë gjasa ka qenë Richard

Adams Locke, një gazetar i Sun. Gazeta nuk e pranoi asnjëherë që lajmi që i sajuar. Është tunduese të themi se ne jemi sot imunë ndaj mashtrimeve të tillë, dhe ndoshta kështu është. Por një kalim i shpejtë i asaj serie na kujton se nuk jemi aq të ndryshëm nga paraardhësit tanë të pothuajse 200 viteve më parë.

Gjendet Planeti Vullkan

Vullkan njihet më së miri sot si vendlindja në letërsi e stoikut Z. Spock tek StarTrek, por për më shumë se gjysmë shekulli ai konsiderohej një planet i vërtetë që vinte në orbitë përreth Merkurit dhe Diellit. Më shumë se një astronom i respektueshëm ka pretenduar atëherë se e ka vënë re. Astronomët kanë vërejtur shumë mospërputhje në orbitën e Merkurit. Në vitin 1860, matematicieni francez Urbain Le Verrier spekuloi që një planet i pavënë re që ushtronte një tërheqje gravitacionale ndaj Merkurit mund të ishte shkakuar i orbitës së tij të çuditshme. Ai ia vuri emrin Vullkan.

Një astronom i quajtur Edmond Lescaubault tha se e kish vënë re planetin një vit më parë. Të tjerë astronomë nisën të thonë se kishin vënë re më herët objekte që kalonin përpara Diellit. Kalimi herë pas here i objekteve që u ngjanin planeleve i bënte astronomët të ripërlogarishin orbitën e Vullkanit. Pas eklipsit diellor të vitit 1878, që u dha astronomëve një shans të rrallë për të parë objektet që normalisht nuk shiheshin prej tij, dy astronomë raportuan se kishin parë vullkanin, apo objekte të tjerë brenda orbitës së Merkurit.

Le Verrier mori medaljen Legjioni i Nderit për shkak se kish parashikuar vendndodhjen e një planeti real: Neptunit. Ai vdiq në vitin 1877 duke besuar ende se kish zbuluar Vullkanin. U desh të vinte viti 1915, me fotografimin e përmirësuar dhe pranimit të teorisë së relativitetit nga Ajnshtajni, e cila shpjegoi çuditë e orbitës së Merkurit, që kjo ide të harrohej.

Marsianët ndërtojnë kanale!

Percival Lowell pa nga një teleskop nga maja e një kodre në Arizonë dhe vërejtë sipërfaqen e Marsit të mbushur me kanale. Qindra milje të gjatë, ata shtriheshin në vija njëshe dhe dyshe që nga polet.

Shpërndarës të ujit për banorët e etur të një planeti që po thahej, kanalet u panë si një tipar spektakolar i inxhinierisë, një përpjekje e dëshpëruar e marsianëve për të shpëtuar botën e tyre.

Lowell ishte një astronom me influencë, dhe kanalet, të cilët ai i hartëzoi me një precizion të lartë, u bënë një temë e debatit shkencor në fillimin e shekullit 20. Ne tani e dimë që kanalet nuk ekzistojnë, po si nisi ky keqkuptim?

Në 1877, Giovanni Schiaparelli, një astronom italian tha se kish parë kanale në sipërfaqen e Marsit. Kur raporti i tij u përkthye në anglisht, canali, që në italisht do të thotë kanal, u përkthye si "Canal" që në anglisht ka kuptimin e kanaleve të bërë nga dora e njeriut.

Imagjinata e Lowellit u ndez nga zbulimet e Schiaparellit. Në 1894, ai ndërtoi një observator në Flagstaff, Arizona, dhe u fokusua tek Marsi. Të tjerë astronomë kishin vërejtur se disa zona të sipërfaqes së planetit dukej se ndryshonin me stinët – blu në të gjelbër gjatë verës dhe e kuqe në dimër. Këta ndryshime dukej se korrespondonin me rritjen dhe tkurrjen e poleve. Lowellit besonte se shkrija e tyre në verë mbushte kanalet me ujë, që furnizonin zona të mëdha vegetacioni. Ai mbushi billoqe të tërë me shënime dhe vëzhgime e skica, si dhe krijoi globe që tregonin rrjetet e mëdha të kanaleve ujorë të ndërtaur nga marsianët.

Ngatërresa e sistemit të kanaleve të Lowellit bëhet edhe më misterioze për faktin që duket se nuk korrespondon me asnjë tipar të planetit sot – megjithatë, ai herë pas here shihje të njëjtë kanale në po të njëjtë vende. Edhe në kohën e Lowellit, shumica e astronomëve të tjerë nuk arrinin të shihnin atë që ai shihje dhe teoria e tij u diskreditua nga shumica e komunitetit shkencor. Edhe sot e kësaj dite askush nuk e di nëse hartat e Lowellit ishin rezultat i lodhjes, iluzionëve optikë, ose ndoshta, modeli i enëve të gjakut në syrin e tij.

Ashtu si çdo ide romantike, besimi tek kanalet marsianë ishte e vështirë të braktisej. Mundësia e jetës në planetin që ndodhet më pranë nesh na ka joshur prej shekujsh dhe vazhdon ta bëjë. Kanalet e Lowellit frymëzuan shkrihtarë fantastiko shkencorë, si H.G. Wells dhe Ray Bradbury. U deshën misionet Mariner në Mars në vitet 60 dhe 70

që të vërtetohet se nuk ka kanale në Planetin e Kuq.

Toka është e zbrazët

Imagjinoni tokën si një top të zbrazët me nga një të hapur në çdo pol. Në sipërfaqen e brendshme ka oqeanë dhe kontinente, ashtu si dhe në atë të jashtme. Kjo është toka siç e shihje Kapiten John Cleves Symmes, një veteran amerikan i luftës së 1812. Ai i ra përreth Amerikës në 1820 duke dhënë leksione për Tokën e zbrazët si dhe duke i bërë thirrje Kongresit të financonte një ekspeditë në pole. Ai shpresonte që sipërfaqja e brendshme e tokës do të eksplorohej dhe do të vendosej tregtia me banorët e saj.

Kjo teori nuk ishte krejt e re – ideja e hapësirave brenda tokës ishte sugjeruar nga mendimtarë të lashtë si Aristoteli, Platoni dhe Seneka. Shpellat dhe Vullkanet mbështesnin këtë teori, dhe kultura është e mbushur me rrëfime dhe legjenda për qytetërimi të fshehur poshtë kores.

Në vitin 1691, për të shpjeguar variacionet në polet magnetikë të Tokës, astronomi Sir Edmond Halley i njohur më së miri për përlogaritjen e lëvizjes së një komete të shndërritshme, propozoi një tokë të zbrazët që përbëhej nga katër sfera koncentrike. Pjesa e brendshme duhet të jetë e ndriçuar dhe e banuar, tha ai; ideja e Krijuesit që nuk kish arritur të populloje tokën dhe të siguroje dritë popullsisë dukej e pamendueshme. Halley thoshte se hapësira e brendshme ndriçohej nga një substancë që jepte dritë dhe tha se aurora borealis shkaktohej nga dalja e saj mbi kore, në pole.

Për ta bërë një ide të çuditshme edhe më të çuditshme, Cyrus Teed, një fizikan, alkimist dhe eksperimentues me elektricitetin i shekullit 19, konkludoi se bota ishte jo vetëm e zbrazët por edhe që në sipërfaqen e brendshme të saj jetonin qenie njerëzore. Ai e pati këtë ide në 1869 kur një vizion ëngjëllor i tha (pasi kish rënë në gjendje shoku pas një eksperimenti) se Teed ishte Mesia. Sipas ëngjëllit, dielli dhe trupat e tjerë diellorë ngriheshin dhe uleshin brenda tokës së zbrazët falë një atmosfere që përthente dritën në zonat ekstreme. I gjithë kozmosi, pretendonte ai, ishte 8000 milje në diametër.

Teed e ndryshoi emrin e tij në Koresh, krijoi kultin e tij, Koreshaniti dhe ndërtoi një ndërtesë për ndjekësit e tij, 250 vetë në jugperëndim të Floridës.

Sulmi i Venusit!

Në 1950, Immanuel Velikovsky botoi "Botë drejt përplasjes", një libër që ngrinte pretendimin e ngjarjeve historike kataklizmatike të shkaktuara nga një kometë e hallakatur. Një psikanalist, Velikovsky përmendte librin e Joshuas në Testamentin e Vjetër, ku thuhet se si Perëndia ndali Diellin nga lëvizja në qiell. Hapja e Detit të Kuq nga Moisiu, pretendonte Velikovsky, mund të shpjegohet prej tërheqjes gravitacionale të Kometës. Ai hodhi teorinë që në vitin 1500 para Krishtit, Jupiteri lëshoi një masë material planetar që mori formë komete përpara se të shndërrohej në Planetin Venus.

Velikovsky ishte njëri në një linjë të gjatë katastrofistësh, mbështetës të teorisë që janë kataklizmat e papritura shpesh herë në formë planetesh që kanë shkakuar shfarosjet në masë apo formimin e tipareve gjeologjike. Libri i tij është i njohur jo aq shumë për shkak të teorive të tij, por për shkak të popullaritetit dhe jetëgjatësisë. Një bestseller i New York Times për 11 javë, ai mund të gjendet në raftet e shkencës edhe sot.

"Botë drejt përplasjes" ndeshi në talljen e shkencëtarëve. Mes problemeve të tjerë, përbërja e Venusit dhe Jupiterit është e ndryshme, dhe energjia që kërkohet për të nxjerrë kaq shumë material do ta kish avulluar planetin që po lindte. Gjatë një debati të 1974 të sponsorizuar nga Shoqata Amerikane për Përparimin e Shkencës, Carl Sagan, astronomi i njohur ishte mes panelistëve që i kundërviheshin Velikovskyt. Por sulmet mund ta kenë forcur pozicionin e tij; për shumë njerëz ai ishte i vogli që i kundërvihje establishmentit të shkencës.

Idetë e Velikovskyt dukeshin radikale një gjysmë shekulli më parë – shumica e astronomëve besonin se ndryshimet planetare ndodhnin me një ritëm të ngadaltë dhe konstant. Ata që kanë mbetur nga mbështetësit e tij përmendin impaktin e asteroidëve të 65 milionë viteve më parë, që shkaktoi zhdukjen e dinosaurëve.

|New Scientist – Bota.al

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON Enverti
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE 'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Sonte përballen Rahoveci - Vëllaznimi, nesër dy ndeshje të tjera

Prishtinë, 4 nëntor - Në fundjavë do të zhvillohet xhiroja e nëntë në Prince Caffë Superligën e Kosovës në basketboll. Ndeshja e vetme e ditës së shtunë, por shumë e rëndësishme, zhvillohet ndërmjet Rahovecit dhe Vëllaznimit. Vreshtarët kanë vetëm një fitore e shtatë humbje radhazi, duke u renditur në vendin e fundit në tabelë, ndërsa kuqezinjtë kanë tri fitore e pesë humbje. Fitorja për të dyja skuadrat është shumë e rëndësishme për synimet që kanë. Të dielën Sigal Prishtina e pret kampionin Golden Eagle Yllin, ku pritet rikthimi i tifozëve. Bardhekaltrit kanë pesë fitore e tri humbje, duke u renditur në vendin e tretë, kurse therandasit pas katër humbjeve shënuan katër fitore radhazi dhe janë në kërkim të fitores së pestë në këtë edicion. Ndeshja e fundit e kësaj xhiroje zhvillohet ndërmjet rivalëve të vjetër të basketbollit të Kosovës, Bashkimit dhe Trepçës. Prizrenasit kanë tri fitore e pesë humbje, kurse

mitrovicasit katër fitore e tri humbje dhe nën drejtimin e trajnerit të ri, Alek Jonceviski, do ta kërkojnë fitoren e pestë në këtë edicion. Për ndeshjen Peja - Ponte Prizreni do të regjistrohet rezultati i Ligës Unike.

Kampionia përballat me nënkampionen

Xhiroja e katërt në Superligën e Femrave do të dhurojë disa ndeshje mjaft interesante. Ndeshja kryesore do të zhvillohet ndërmjet nënkampiones, Prishtinës dhe kampiones, Penzas. Edicionin e kaluar Prishtina në garat e rregullta kishte 20 fitore e asnjë humbje, por në finale të "Play-off-it" pejanet fituan 3:1 dhe fituan titullin në Kosovë. Në këtë edicion të dyja skuadrat kanë nga dy fitore e një humbje dhe pritet një ndeshje interesante dhe rivalizuese. Bashkimi që e ka nisur edicionin me



tri fitore e asnjë humbje do të ndeshet me Trepçën dhe shihet favoriti ndaj skuadrës mitrovicase që

ka një fitore e dy humbje. Në takimin tjetër do të ndeshen Vëllaznimi me United Basketball. Skuadra kuqezi

PRINCE CAFFE SUPERLIGA - JAVA 9

Të shtunën takohen:
19:00 Rahoveci - Vëllaznimi

Të dielën takohen:
17:00 Sigal Prishtina - Golden Eagle Ylli
19:00 Bashkimi - Trepça
Peja - Ponte Prizreni (rezultati i Ligës Unike)

SUPERLIGA E FEMRAVE - JAVA 4

Të shtunën takohen:
15:00 Trepça - Bashkimi

Të dielën takohen:
14:00 Vëllaznimi - United Basketball
20:00 Prishtina - Penza

nga Gjakova do ta kërkojë fitoren e parë për këtë edicion, ndërsa ajo gjilanase ka një fitore e dy humbje.

Sot derbi Prishtina - Gjilani, nesër Drita - Ballkani

PRISHTINË, 4 NËNTOR - Java e 15-të e Superligës së Kosovës në futboll rikthehet me ndeshje shumë interesante. Në kuadër të kësaj xhiroje do të zhvillohen dy ndeshje derbi, fillimisht sot (e shtunë) nga ora 18:00 përballen Prishtina - Gjilani në stadiumin "Fadil Vokrri". Këto dy skuadra ndajnë pozitën tre dhe katër më nga 22 pikë, por kryeqytetasit kanë një ndeshje më pak të zhvilluar. Ndërsa nga ora 13:00 do të ballafaqohen Dukagjini - Malisheva dhe Trepça



'89 - Drenica. Të dielën zhvillohet derbi tjetër në mes të Dritës dhe kampionit në fuqi, Ballkanit. Drita është lidere e elitës me 30 pikë të grumbulluara, kurse Ballkani zë vendin e dytë me

26 pikë, por ka dy ndeshje më pak të zhvilluara për shkak të pjesëmarrjes në garat e Ligës së Konferencës. Gjithashtu, nesër në program është edhe ndeshja në mes të Llapit dhe Ferizajt.

EHF-ja shkruan për suksesin e Kosovës: Natë historike në Istog

PRISHTINË, 4 NËNTOR - Federata Evropiane e Hendbollit ka shkruar për fitoren e Kosovës ndaj Ishujve Faroe të enjten mbrëma. Sipas EHF-së, fitorja dëshmon rritjen e vazhdueshme të Përfaqësueses së Kosovës në Hendboll (vajzat). "Kosova nuk kishte fitore në fazën kualifikuese për Kampionatin Botëror, por rritja e formës u dëshmuar në

kualifikimet e kaluara për Evropian dhe kjo u konfirmua në një natë historike në Istog, ku lojtaret e Kosovës siguruan fitore të shkëlqyer ndaj Ishujve Faroe. E udhëhequr nga Leonora Demaj që shënoi 9 gola, Kosova nuk shikoi për asnjë moment prapa dhe bëri një hap të madh drejt kalimit në fazën tjetër", ka shkruar EHF-ja.



SUPERLIGA / Java e 15-të.

Të shtunën takohen:
Dukagjini - Malisheva
Trepça '89 - Drenica
Prishtina - Gjilani

Të dielën takohen:
Drita - Ballkani
Llapi - Ferizaj

Federata e Padelit e Kosovës pranohet në FEPA

PRISHTINË, 4 NËNTOR - Një lajm i mirë ka ardhur në adresën e Federatës së Padelit të Kosovës e cila është pranuar me të drejta të plota në Federatën Evropiane të Padelit (FEPA). Pas takimit të

Bordit të FEPA-s, aplikimi i Kosovës ka kaluar me sukses, kurse tash e tutje Federata e Padelit e Kosovës do të jetë pjesëmarrëse edhe në Asambleenë Gjenerale të organizuar nga Federata

Evropiane e Padelit (FEPA). Anëtarësimi në Federatën Evropiane do t'i hapë dyert për garuesit nga Kosova për pjesëmarrje në turne të ndryshëm. Madje në fund të këtij muaji do të zhvillohet

Kampionati Evropian i Padelit që organizohet në Lisbonë të Portugalisë nga data 25 deri më 26 nëntor. Kosova ka pranuar ftesën për dërgimin e dy çifteve në të dyja kategoritë.



Nadali: Dua të luaj sa më shumë, mund të tërhiqem në çdo çast

MADRID, 4 NËNTOR - Eliminimi i shpejtë i Rafael Nadalit nga turneu Masters i Paris-Bercy ka vënë shumë pikëpyetje për të ardhmen e tenistit spanjoll. Numri dy në botë u eliminua që në sfidën e parë në këtë turne, ndërkohë që forma e tij fizike nuk ishte ende e mirë. “Nuk bëra një ndeshje të mirë,

por janë gjëra që ndodhin”, ka thënë Nadali. “Muajt e fundit kanë ndodhur shumë gjëra, por unë dhe stafi im jemi gjithnjë gati për të gjetur një rrugë të drejt fitores. Gjithsesi, nuk ka justifikime: Nëse luan mirë do të fitosh, nëse luan keq do të humbasësh”, u shpreh spanjoli.

Në lidhje me praninë e tij në finalët ATP, pas disa ditësh në Torino, ai ka konfirmuar se do të jetë pjesëmarrës dhe se do ta shijojë në maksimum. “Sigurisht se do të jem. Muajt e fundit nuk kanë qenë të përkryer, por kam dëshirë të luaj, nuk kam asgjë për të humbur. Kam nevojë të luaj sa

më shumë, të jem sa më shumë në fushat e tenisit ashtu si dikur. Do të shkoj në Torino më herët dhe dua ta shijoj turneun e fundit të këtij sezoni. Në moshën time nuk i dihet kurrë se kur do të jetë fundi. Ndoshta s’do të jem ende në formën optimale, pasi të luash ndaj më të mirëve duhet ritëm



dhe qëndrueshmëri, të cilat për momentin më mungojnë. Ndaj dua të stërvitem dhe luaj sa më shumë për ta fituar ritmin e duhur”, ka deklaruar Nadal.

Reja publikon listën për miqësoren me Katarin

TIRANË, 4 NËNTOR - Trajneri i Kombëtares së Shqipërisë, Edoardo Reja, publikoi listën me lojtarët e grumbulluar për miqësoren e datës 9 nëntor në orën 18:30 ndaj Katarit në Spanjë. Ashtu siç pritej, tekniku italian i beson dhe ua jep shansin lojtarëve të Kategorisë Superiore teksa ka përjashtuar Kristal Abazajn që vjen nga radhët e turqve të Istanbulsporit. Të gjithë lojtarët e tjerë aktivizohen në kampionatin shqiptar. Për ndryshim nga lista e kaluar për miqësoren me Arabinë Saudite, janë ftuar edhe portierët Mario Dajsinani (Laçi) e Alen Sherri (Egnatia), konfirmohet Arlis Shala i Drenicës. Ndërsa në mbrojtje pranë kombëtares rikthehen Marsel Ismajlgeci (Tirana), Artan Jazxhi (Teuta), teksa konfirmohen Albion Marku, Erdenis Gurishta, Andi Hadroj, Esin Hakaj, Rudolf Turkaj, Stivian Janku e Eneo Bitri. Në mesfushë risia për këtë miqësore është Arbin Zejnullai i Egnatias, Kristal Abazaj (Istanbulspor), Serxho Ujka



Lista e lojtarëve

Mario Dajsinani, Alen Sherri, Arlis Shala, Albion Marku, Erdenis Gurishta, Andi Hadroj, Esin Hakaj, Rudolf Turkaj, Stivian Janku, Marsel Ismajlgeci, Eneo Bitri, Artan Jazxhi, Herald Marku, Sherif Kallaku, Serxho Ujka, Kristal Abazaj, Ardit Deliu, Arinaldo Rrapaj, Arbin Zejnullai, Xhuliano Skuka, Redon Xhixha, Lorenca Vila, Tedi Cara.

(Laçi) dhe Herald Marku i Vllaznisë teksa konfirmohen Sherif Kallaku, Ardit Deliu, Odise Roshi, e Arinaldo Rrapaj. Në repartin ofensivë, përveç

Xhixhës (Tirana), L.Vila (Teuta), Skuka (Partizani) që ishin edhe në miqësoren e fundit, është shtuar edhe një tjetër lojtar i Partizanit, Tedi Cara.

Golden State në krizë, Denveri mposhti Oklahomën

DENVER, 4 NËNTOR - Vijon kriza e skuadrës kampione të Golden States, që pësoi humbjen e katërt radhazi në NBA. Warriorsi u mund me rezultat 130-129 nga Orlando, një ndeshje me rivalitet dhe e hapur deri në sekondën e fundit. Interesant fakti që Golden State ende nuk ka asnjë fitore jashtë fushës. Stephen Curry realizoi 39 pikë, ndërsa Klay Thompsoni 27 pikë, por që s’mjaftuan për ta evituar humbjen. Për Orlandon, shtatë lojtarë realizuan mbi 10 pikë, ku më të mirët ishin Suggs me 26 pikë e Banchero me 22 pikë. Pa problem fitoi skuadra e Denverit, që mundi me rezultat 122-110 Oklahomën, në një ndeshje ku



veçohet paraqitja e Nikola Jokiqit, autor i një “triple double” (15 pikë, 13 rebounde e 14 asistime). Ai bëhet qendra me më shumë “triple double” në historinë e NBA-së, me 79 të tilla, duke kaluar legjendën

Wilt Chamberlain. Gjithsesi, shënuesit më të mirë për Denverin ishin Gordon me 27 pikë e Murray me 24 pikë, duke i bërë të pavlefshme 37 pikët e Shait për Oklahomën.

SHKURT

Chelsea e dëshiron Leon, Broja mund të kalojë në Milan

Sulmuesi i Kombëtares së Shqipërisë, Armando Broja, mund ta veshë fanellën e Milanit në muajin janar. “TuttoMercatoWeb” raporton se Chelsea ka treguar interesim për yllin e Milanit, Rafael Leao, që vlerësohet 120 milionë euro, por në kuadër të marrëveshjes dëshiron që ta përfshijë edhe sulmuesin shqiptar Armando Broja që ka vlerën e 30 milionëve. Sipas medieve në Itali, këto transferime mund të realizohen për faktin se Broja pëlqehet nga Milani.

Mourinho tallet me Taren pas eliminimit nga Liga e Evropës

Lazio e Igli Tares u eliminua nga Liga e Evropës dhe tashmë do ta vijojë aventurën në Ligën e Konferencës. Rënia në kompeticionin e tretë për klube në Evropë ka sjell dhe ironitë e shumta në drejtim të drejtorit shqiptar të bardhekaltërve. Para tri javësh Tare ka deklaruar se Liga e Konferencës është për humbës të tillë si Roma, por tashmë ekipi i tij do të duhet të luajë në të njëjtën kompeticion me Jose Mourinhon. Strategu portugez, si mjeshër për batuta, nuk i kurseu menjëherë thumbimet ndaj Tares pas kualifikimit ndaj Ludogoretsit. “Lazio është favorite për mua. Ata kanë trajner, lojtarë dhe ekip për ta fituar këtë trofe. Problemi do të jetë tek Igli Tare që nuk e pëlqen këtë kompeticion”, ka thënë Mourinho.

Kloppi: Nunezi është i jashtëzakonshëm

Darwin Nunez me tre gola në pesë ndeshjet e fundit, po rritet në formë te Liverpooli, një skenar i theksuar edhe një herë nga trajneri Jurgen Klopp, në pritje të ndeshjes së fundjavës kundër Tottenham Hotspurit. “Darwini është një kërcënim real në zonë për kundërshtarin. Ai është i përfshirë në gjithçka, është gjithmonë një opsion për të kaluar. Ai ishte i përfshirë në të dyja golat të martën kundër Napolit, pasi shënoi njërin prej tyre, kështu që është e qartë se ai po bën hapa të mëdhenj. Ai është përmirësuar shumë dhe ka hapësirë për t’u përmirësuar. Ai është i jashtëzakonshëm”, ka thënë Klopp.

Ronaldo: Nuk isha i lumtur kur filluan të më thërrisnin ‘fenomen’

Ish-futbollisti i famshëm brazilian Ronaldo ka treguar pse nuk donte të quhej “fenomen”. “Nuk isha i lumtur kur filluan të më thërrisnin kështu në Itali. Një pseudonim i tillë më vuri një barrë përgjegjësie shtesë, të cilën nuk e dëshiroja aspak. Dukej se pritej diçka e pamundur nga unë, të isha gjithmonë në krye, të mos ndaloja kurrë së shënuari, të mos ndieja kurrë dhimbje”, ka thënë braziliani në një intervistë për DAZN. Ronaldo përfundoi në Itali në verën e vitit 1997, pasi kaloi nga Barcelona tek Interi për 26.5 milionë euro. Ish-sulmuesi ka luajtur edhe për Real Madridin dhe Milanin.

Brooklyn suspendon Irvingun me pesë ndeshje pa pagesë

Brooklyn Netsi ka suspenduar yllin e skuadrës, Kyrie Irving. Pas një postimi të diskutueshëm javën e kaluar në të cilin Irvingu dukej se mbështeste një film dokumentar që përmban ide

antisemitike (gjuhën e urrejtjes drejtuar hebrenjve) dhe disa konferenca shtypi gjatë të cilave basketbollisti refuzoi ta dënonte antisemitizmin. Klubi i tij e ka suspenduar atë me pesë ndeshje pa pagesë. “Ne

ishim të tronditur sot, kur u dha një mundësi në një seancë mediatike, që Kyrie refuzoi të thoshte pa mëdyshje se nuk ka besime antisemitike, as të pranojë materiale specifike urrejtjeje në film. Kjo nuk ishte

hera e parë që ai kishte mundësinë, por nuk arriti të sqaronte. Dështimi i tillë për ta mohuar antisemitizmin kur i jepet një mundësi e qartë për ta bërë këtë është thellësisht shqetësues, është në

kundërshtim me vlerat e organizatës sonë dhe përbën sjellje të dëmshme për ekipin. Prandaj, ne jemi të mendimit se ai do të suspendohet me pesë ndeshje pa pagesë”, thuhet në një deklaratë të klubit.





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

